 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
 - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
I. Sistemi software per Menaxhimin e Taksave Vendore (Upgrade e permiresimi i sistemit)					
01	Levrimi, Instalimi, Konfigurimi i Sistemit Software (Server)	licensa	1		
02	Levrimi, Instalimi, Konfigurimi i Sistemit Software (Perdorues)	licensa	30		
03	Migrimi i te dhenave nga DB ekzistues ne DB e sistemit te ri software	sherbim	1		
04	Trajnimi i administratoreve e perdoruesve te sistemit	dite	2		
05	Asistence teknike on line per venjen ne efience te plote te sistemit	dite	10		
Shuma I(pa tvsh)					
II. Mirembajtja					
06	Mirembajtja, asistenca teknike dhe upgrade i sistemit software per Menaxhimin e Taksave Vendore per periudhen 1 vjeçare	Vit	1		
Shuma II(pa tvsh)					
Shuma Totale					

Afati I realizimit te sherbimit

- I. Per 2 muaj pas lidhjes kontrates
- II. 12 muaj pas upgrade e permiresimit

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

“Mirembajtja dhe zhvillimi i sistemit elektronik i taksave dhe tarifave vendore”

1. Detyrat

Objekti kryesor është “Upgrade, zhvillimi dhe mirembajtja e sistemit Informatik për Menaxhimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamez” me qëllim zgjidhjen e problemeve, shtimin e përmirësimit dhe funksioneve të sistemit aktual që përdoret në Bashkinë Kamez. informatizimin dhe proceset kryesore të punës që lidhen me shërbimin dhe llogaritjet dhe likuidimit të taksave dhe tarifave.

Komponenti kryesor i Sistemit, të cilët janë edhe objekt i këtij shërbimi është:

- Aplikacioni software, për ruajtjen dhe gjenerimin e të gjithë detyrimeve të subjekteve dhe pronarëve sipas VKB përkatëse
- Baza e të dhënave duhet të ofrojë integritet, siguri të të dhënave dhe performancë të lartë

Qëllimi i programit të taksave dhe tarifave vendore është regjistrimi i të gjithë subjekteve që paguajnë taksë dhe tarifë vendore pranë bashkisë, përcaktimi i detyrimeve për çdo subjekt të regjistruar, regjistrimi i pagesave të bëra prej tyre si dhe gjenerimi i të dhënave me karakter statistikor dhe financiar mbi ecurinë e të ardhurave vendore në vite sipas taksave dhe tarifave, subjekteve etj. Sistemit i Menaxhimit të taksave dhe tarifave Vendore ka si qëllim informatizimin dhe proceset kryesore të punës që lidhen me shërbimin dhe llogaritjet dhe likuidimit të taksave dhe tarifave vendore. Funksionalitetet kryesore të kërkuara përfshijnë:

- ✓ Regjistrimi i referencave të detyrimeve (taksa/tarifë/gjoha) sipas VKB përkatëse dhe legjislacionit në fuqi
- ✓ Regjistrimin e të dhënave për Subjektet
- ✓ Gjenerimi automatik i detyrimeve sipas VKB për çdo Subjekt
- ✓ Likuidimi i detyrimeve përmes ndërfaqeve (arka/banka)
- ✓ Gjenerimi i raporteve mbi likuidimet, detyrimet, subjektet etj. sipas filtrave përkatëse (Ditari i plotë/analitik, Raporte financiare,) si dhe gjenerimin e "vertetimit likuidimit", "njoftim detyrimi", "urdher bllokimeve" etj
- ✓ Administrimi i përdoruesve sipas roleve/të drejtave
- ✓ Auditimi i veprimeve në sistem

Programi parashikohet të funksionojë në një rrjet kompjuterash. Pra përdorues të ndryshëm duhet të punojnë njëkohësisht në ambiente të ndryshme të programit (P.sh regjistruarit do të merren me regjistrimin e subjekteve, inspektorët do të gjenerojnë taksat, arkëtarët dhe financiarët-likuidimet, supervisorët/administratoret do të kenë të drejtën për të hyrë dhe për të kryer veprime në të gjitha ambientet e programit etj.).

Për të bërë të mundur funksionimin normal të programit, përdoruesve të ndryshëm u përcaktohen role të ndryshme, në varësi të të cilëve ata përfitojnë mundësinë e hyrjes në ambjentin përkatës, kryerjen e veprimeve në të nëpërmjet fjalëkalimit individual të çdo përdoruesi, sipas të drejtave dhe përgjegjësive.

2. Funksionalitetet e programit të taksave e tarifave vendore

Programi i taksave dhe tarifave vendore duhet të kryejë një sërë funksionesh, të cilat grupohen si më poshtë:

3.1 Regjistrimi i Referencave sipas paketës fiskale dhe VKB përkatëse.

Regjistrimi i detyrimeve për cdo taksë, tarifë apo pagesë tjetër të subjekteve duhet të mundesohet përmes nderfaqeve dinamike e fleksibel të referencave, të cilat mundesojnë konfigurime të struktura të detyrimeve, zonave, kalendarit të pushimeve, etj . Në këtë ambjent duhet të kryhen regjistrimet e veprimeve të përditëshme pranë drejtorise së taksave, ku përfshihen: regjistrimi i gjenealiteteve të subjekteve, detyrimet për taksat, penalitetet etj.

3.2 Regjistrimi

Regjistrimi i subjekteve me të dhënat e tyre të përgjithshme. Çdo subjekt identifikohet me një menyrë unike. Për secilin subjekt përcaktohen të gjitha llojet e taksave, tarifave dhe penalitetet që duhet të paguajë sipas llojit të aktivitetit. Të dhënat e regjistrimit të subjektit duhet të përfshijnë të dhënat kryesore nga QKB për të gjitha format e biznesit.

Nderfaqja e regjistrimit krahas këtyre të dhënave duhet të përmbajë dhe të dhënat mbi taksat dhe tarifatat vendore të cilat aplikohen nga Bashkia Kamez, sipas përcaktimeve në legjislacionet në fuqi dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak.

Nr identifikimi unik

Ky kod duhet të shërbejë për identifikimin në menyrë unike të subjektit në sistem.

Te dhënat për identifikimin të subjektit

Përcaktohet nga të dhënat e QKB (NIPT, Emri i Subjektit, data e licencimit, lloji i aktivitetit, niveli i xhiros) etj. sipas legjislacionit në fuqi.

Gjendja Aktive/Pasive/Pezulluar/Aplikim për Ç' regjistrim

Kjo fushë paraqet gjendjen e subjektit (Aktive/Pasive/Pezulluar/Aplikim për Cregjistrim) kur kërkohet nga operatori. Dallimi i gjendjeve bëhet nëpërmjet selektimit apo mosselektimit të fushës. Në përputhje me gjendjen duhet të realizohet dhe rillojaritja e detyrimeve.

Funksion tjetër i rëndësishëm i kësaj fushe është se shërben si filtër për të gjithë raportet e tjera nga ku bëhet gjenerimi i të dhënave të subjekteve.

Emri i Pronarit objekt i taksës mbi ndërtesën / truallin /token bujqesore

Përcakton qartësisht subjektin i cili është objekt i taksës mbi ndërtesat/ truallin /token bujqesore, i cili mund të jetë subjekt ose individ që i ka dhënë me qera subjektit pronën që regjistrohet.

Kjo pjesë duhet të përmbajë:

Nr identifikimi unik

Emri i pronarit

Atësia

Mbiemri i pronarit
Datëlindjen
Vëndlindjen
Nr. Pasaportës
Adresa e pronës
Adresa e banimit
Numri i kontaktit etj.

3.3 Llogaritja e detyrimeve dhe regjistrimi i pagesave.

Pasi kryhet regjistrimi i të dhënave për bizneset, fillon përcaktimi dhe llogaritja automatike e detyrimit që duhet të paguajë subjekti sipas llojit të taksave, tarifave si dhe penaltitetet e mundshme.

1. Gjenerimin automatik i detyrimeve sipas paketës fiskale dhe VKB përkatëse
2. Gjenerimin automatik i gjobave dhe penaltiteteve sipas legjislacionit në fuqi

Mbasi kryhet regjistrimi i të dhënave për bizneset, fillon përcaktimi dhe llogaritja automatike e detyrimit që duhet të paguajë subjekti sipas llojit të taksave, tarifave si dhe penaltitetet e mundshme. Aplikimi i taksave dhe tarifave vendore bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe VKB përkatëse. Nga llogaritja e detyrimeve për të gjitha taksat dhe tarifatat vendore printohen dhe një sërë raportesh për njoftimin e detyrimeve të cilat ju dorëzohen subjekteve/inividëve në periudha të caktuara kohore si më poshtë:

Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin automatik të detyrimeve si dhe një sërë njoftimesh automatike për subjektet si më poshtë vijon:

Fature e arketimit për taksat dhe tarifatat vendore ndër vite.

Ky raport shërben si faturë e cila printohet dhe i dërgohet apo i dorëzohet subjektit, për t'i evidentuar atij detyrimet që ka për taksat/tarifatat në vitin korent apo dhe ndër vite. Në të shfaqet, për çdo subjekt, të dhënat identifikuese të tij (nipti, emërtimi, administratori), si dhe një tabelë me vlerat përkatëse të detyrimit që ka subjekti, për çdo lloj takse dhe tarife apo pagese tjetër ndër vite. Ky raport përmban:

- Viti korent dhe vitet e tjera që nga momenti kur subjektit i kanë lindur detyrimet
- Numri unik i identifikimit
- Subjekti
- Administratori
- Pronari
- Forma juridike
- Lloji i biznesit
- Emërtimi tregtar i biznesit
- Adresa
- Detyrimi për çdo taksë/tarifë apo pagesa të tjera gjobat, kamat vonesat.
- Pagesën për çdo taksë/tarifë apo pagesa të tjera sipas viteve
- Vlerën debitore të mbetur për tu paguar për çdo taksë/tarifë apo pagesa të tjera sipas viteve gjobat, kamat vonesat.
- Vlerën totale të detyrimeve dhe likuidimeve për të gjitha vitet.

Në këtë ndërfaqe duhet të shfaqen të gjitha të dhënat mbi afatet e pagesave, vendin, si dhe çdo njoftim tjetër i nevojshëm ligjor.

Njoftim per debitorët - për taksat dhe tarifën vendore ndër vite.

Është një faturë në formën e kujtesorit i cili duhet të gjenerohet në mënyrë automatike për të gjitha ato subjekte të cilat nuk paguajnë detyrimet vendore brenda afatëve kohore. Forma e tij do të përmbajë të gjitha të dhënat analitike sipas formës së faturës së arketimit

Dhënia e Vërtetimit për pagesën e taksave vendore

Ky vërtetim jepet për ato subjekte të cilët kanë paguar detyrimet vendore dhe kërkojnë printimin e një dokumenti vërtetues.

Ky vërtetim nuk duhet të gjenerohet nëse subjekti ka detyrime të prapambetura

Vërtetimi duhet të përmbajë:

- Numri unik i identifikimit
- Subjekti
- Administratori
- Pronari
- Forma juridike
- Lloji i biznesit
- Emërtimi tregtar i biznesit
- Adresa
- Pjesa e komentit ku specifikohet baza ligjore mbi të cilën lëshohet vërtetimi dhe periudha e vlefshmërisë së vërtetimit.

Njoftim për pagesën e detyrimeve vendore

Ky njoftim duhet të ketë karakter informues dhe duhet të gjenerohet automatikisht nga programi për të gjitha subjektet.

Njoftim Detyrimi duhet të përmbajë.

- Numri unik i identifikimit
- Subjekti
- Administratori
- Pronari
- Forma juridike
- Lloji i biznesit
- Emërtimi tregtar i biznesit
- Adresa
- Te dhëna shtese si afatet e pagesës së detyrimeve, data, etj.

3.4 Regjistrimi i Likuidimeve

Mbas përcaktimit të detyrimeve që duhet të paguajnë subjektet ata mund të drejtohet bankës ose arkës për të ekzekutuar pagesat. Ky është një moment shumë i rëndësishëm ku regjistrohet pagesat në arkë dhe bankë në varësi të vëndit ku subjekti ka kryer pagesën.

Arka

Në këtë ambient regjistrohen të gjitha pagesat që bëhen nga subjektet taksapagues pranë arkës dhe pagesat për tarifa të ndryshme nga strukturat e Bashkisë. Për realizimin e këtyre veprimeve operohet me këto fusha:

-
- **Fusha/Njësia**
Plotësohet me njësinë e likuidimit (arkën) në të cilën po bëhet pagesa. Mendohet që puna të organizohet me 2 arka, ku përzgjidhet njësia e likuidimit me të cilën do të punoj arkëtari

 - **Fusha/Nr. Dok/Dt.dokumentit**
Vihet numri që ka dokumenti i arkëtimit dhe që shërben për identifikimin e tij. Numri i dokumentit gjenerohet në mënyrë progresive, automatikisht.
Element i rëndësishëm është edhe regjistrimi i datës së dokumentit (data në momentin e kryerjes së veprimit) që korrespondon me pagesën e subjektit.

 - **Fusha/ Kodi unik i identifikimit/NIPT**
Plotësohet me kodin e subjektit që do të likuideojë detyrimet vendore dhe me plotësimin e tij gjenerohet automatikisht Emri, Administratori dhe Adresa e subjektit të përzgjedhur etj.

 - **Fusha/Vlera**
Shënohet vlera që paguhet gjithsej pas regjistrimit të të gjitha vlerave për çdo taksë apo tarifë nga arkëtari. Kjo fushë pranon vetëm numra dhe gjeneron shumë në mënyrë automatike.

Pas plotësimit të këtyre fushave, përzgjidhet konkretisht periudha dhe detyrimet që likuidon subjekti:

 - **Fusha/Viti**
Përzgjidhet viti, detyrimi për të cilin po paguan subjekti në të gjitha vitet për të cilat ka detyrime.

 - **Fusha/Lloj Takse/tarifë/detyrime të tjera**
Përcaktohet tatimi/taksa/detyrime të tjera për të cilën po likuidon subjekti në fjalë dhe përzgjidhet nga arkëtari çdo lloj takse/tarife apo pagesë tjetër për të cilën subjekti po kryen likuidimin.

 - **Fusha/Periudha**
Përcaktohet periudha e pagimit të taksës në rastin e taksave/tarifave që kanë periudha pagese më pak se një vit si mujore, 3-mujore e 6-mujore ku zgjidhet periudha e detyrimit për të cilën po likuידohet me arkëtimin në fjalë.
Nuk mund të likuידohet detyrimi për një periudhë të caktuar nëse nuk është likuידuar detyrimi për periudhat paraardhëse. Programi duhet të shfaqë një mesazh informues pengues.

 - **Fusha/Kod njësi**
Caktohet kodi i njësisë objekt takse, për të cilën po bëhet likuידimi. P.sh. në qoftë se për subjektin në fjalë, për tatimin mbi pasurinë janë bërë disa regjistrime; nga një për cdo objekt/aktivitet në pronësi të tij, përzgjidhet numri përkatës i objektit/aktivitetit detyrimin e të cilit po likuידon subjekti.

 - **Fusha/Detyrimi**
Gjenerohet automatikisht nga programi detyrimi total dhe i detajuar për çdo lloj takse i regjistruar më parë nga operatori i taksave. Një gjë e tillë bën të mundur që subjekti të mund të shkojë direkt në arkë për të paguar detyrimin nëse ai është i regjistruar më parë.

- **Fusha/Paguar**

Plotësohet nga arkëtari me shumën që paguan subjekti, për llojin e përzgjedhur të taksës. PAGESA mund të kryhet e plotë ose e pjesshme në varësi të ngarkesës tatimore të përcaktuar më pare.

- **Fusha/Komente**

Mund të shkruhen komente të ndryshme për regjistrimin e bërë.

Pas ruajtjes së regjistrimeve të pagesave, realizohet printimi i mandat – arkëtimit me të dhënat e gjeneruara automatikisht nga programi.

Mandat arkëtimi duhet të përmbajë:

- Nr. Mandati
- Datë
- Kodi unik i identifikimit
- NIPT
- Subjekti që arkëton (Emri Atësia Mbiemri/Emri Juridik)
- Viti i pagesës
- Lloji Taksës/tarifës/detyrime të tjera me shumën përkatëse (shprehur në forme analitike)
- Periudha
- Shuma në lekë në total Arkëtari/Financieri/*Banka*

Regjistrimet me bankë bëhen në mënyrë krejt të ngjashme me regjistrimet e arkës. Plotësimi i fushave është i ngjashëm si të arka. Ndryshimi qëndron vetëm në plotësimin e fushës ku përzgjidhet njësia e çelur si *Bankë*.

3.5 Administrimi i Roleve dhe të Përdoruesve

Regjistrimi i përdoruesve në sistem duhet të sigurojë autentifikimin e tyre. Rolet e përdoruesve duhet të jenë dinamike për një përdorim sa më fleksibel dhe eficient të sistemit. Administrimi i sistemit do të bëhet nga punonjësit e Bashkisë. Sistemi do të funksionojë mbi bazën e fjalëkalimeve për çdo përdorues. Ai do të sigurojë grupimin dhe kategorizimin e përdoruesve mbi kriteret:

- Sistemi duhet të suportoje përdorues të pakufizuar në numër.
- Rolet e ndryshëm të përdoruesve përcaktohen sipas kërkesës së Bashkisë.
- Të drejtat sipas roleve të përdoruesve përcaktohen sipas kërkesës së Bashkisë

3.6 Kontrolli/Administrimi

Kontrolli dhe administrimi i veprimeve të përdoruesve në sistem duhet të përfshijë:

- Të realizohet ndjekja e detyrimeve për çdo subjekt nëpërmjet raporteve të shumta.
- Mbrojtjen e sistemit nga hyrjet e paautorizuara.
- Ndërtimi i historikut të përdoruesve dhe veprimeve të tyre në sistem.
- Të realizohen raporte të detajuara mbi auditimin e veprimeve të përdoruesve.
- Të vendosen kritere plotësuese si p.sh bashkangjitja e një dokumenti/shkresë për justifikimin e veprimeve sensitive
- Të realizohen raporte të detajuara mbi historikun e subjekteve/njesive

3.7 Gjenerimi i raporteve

Gjenerimi i nje shumëllojshmërie raportesh; për të gjitha taksat, tarifatat dhe cdo lloj tjetër detyrimi që mbartin subjektet e regjistruara, detyrimet dhe likuidimet për cdo subjekt etj.

Filtrimi i informacionit sipas një sistemi të pasur të dhënash që ndihmon në gjenerimin e informacionit sipas kërkesave të përdoruesve të brendshëm ose të jashtëm.

Raportet e sistemit duhet të exportohen sipas kërkesave në formate (xls, pdf etj.)

Raporte të rëndësishme

1 Të dhëna kryesore të Subjekteve. Duhet të gjenerojë të gjitha të dhënat mbi subjektet që likuoidjnë detyrimet vendore me arkë, bankë.

- Nr.
- Nr.Njësisë (Arka, Banka)
- Kodi vendor
- Kodi unik i identifikimit
- Viti i regjistrimit
- Arketimet
- Derdhjet
- Ditari i plote
- Ditari analitik
- Subjekti objekt i taksës Emër Atësia Mbiemër
- Adresa e aktivitetit
- Nr.dokumentit të arkës, bankës
- Data e veprimit arkë, bankë
- Periudha e taksës (mujore, vjetore, kesti)
- Vlera e likuiduar
- Lloji i taksës së likuiduar
- Komente

2 Raporti mbi Ditarin e plotë

Te behet e mundur paraqitja e subjekteve të likuiduar për çdo ditë, muaj dhe vit duke shfrytëzuar të dhënat kryesore.

Theksojmë se ky ditar paraqet vlerën totale të detyrimit të paguar pa specifikuar llojin e taksës.

Ky raport duhet të përmbajë:

- Data e printimit të ditarit
- Nr. Njësisë (Arka, Banka)
- Nr. rendor
- Nr. dokumentit të arkës, bankës
- Data e veprimit arkë, bankë
- Vlera e likuiduar
- Subjekti objekt i taksës Emër Atësia Mbiemër
- Komente
- Duhet që ky raport të japë të dhëna të sakta për pagesat e kryera nga subjektet në çdo njësi (arkë, bankë) në vlerë totale dhe për çdo periudhë të kërkuar, viti korent dhe ndër vite.

Raporti mbi Ditarin analitik

Te behet e mundur paraqitja e subjekteve të likuiduar për çdo ditë, muaj dhe vit duke shfrytëzuar të dhënat ku si elementë kryesorë mund të përmendim:

- Data e printimit të ditarit
- Nr.Njësisë (Arka,Banka)
- Nr.dokumentit të arkës,bankës
- Data e veprimit arkë,bankë
- Subjekti objekt i taksës Emër Atësia Mbiemër
- Lloji i taksës së likuiduar
- Periudha e taksës (mujore,vjetore,kesti)
- Vlera e likuiduar për çdo taksë
- Vlera totale e likuiduar nga çdo subjekt
- Komentë

Ky raport duhet të japë të dhëna të sakta për pagesat e kryera nga subjektet në çdo njësi (arkë, bankë), vlerën për çdo lloj takse dhe në total, si dhe për çdo periudhë të kërkuar, pëe vitin koherent dhe ndër vite.

Raporti mbi ndryshimet e gjendjeve/llojit te biznesit

Duhet parashikuar në program dhe raporte te hollësishme mbi **ndryshimet e aplikuara**:

- Raport mbi pezullimet
- Raport mbi ndryshimet e llojit te biznesit

Raporte financiare

Raporti i realizimit të të ardhurave ditore/mujore dhe progresive për vitin koherent. Informacioni duhet të gjenerohet automatikisht nga programi për taksat, tarifat/pagesat e tjera si dhe nga burime të jashtëme jo të informatizuara në program, ku të ketë fushatë lira për hedhje në mënyrë manuale.

Ky raport duhet të përmbajë:

- Numri rendor
- Emërtimet e taksave dhe tarifave vendore
- Fakti i likuidimeve arkë/bankë
- Numri i subjekteve të likuiduara

Raporte kontabiliteti

Ky raport duhet të kryejë kontabilizimin ditor të të ardhurave, ku çdo subjekt që debitohet për shumën e detyrimit për taksat e tarifave vendore të kreditohet për pjesën e likuiduar.

E rëndësishme mbetet paraqitja e Llogarisë “Debitorë” e cila duhet të përmbajë:

- Gjendjen e subjekteve debitorë sipas viteve

-
- Për çdo periudhë të kërkuar
 - Në numër dhë në vlerë
 - Për çdo lloj takse që mbarten detyrime.

Printimi në çdo moment i gjendjes financiare të çdo subjekti ku të përshkruhen ndërhyrjet në detyrime e likuidimet perkatese

Raporte të tjera

Nxjerrja e të dhënave sipas filtrave perkatese si dhe te mundësohet paraqitja grafike e të dhënave.

Funksione te tjera

Kontraktori duhet te realizoje dhe integroje ne kuader te upgrade e zhvillimit te sistemit ekzistues dhe modulet (web service) per te bere te mundur:

1. Krytjen nepermjet faqes e-albania:
 - Njoftim Detyrimi per tatimpaguesit
 - Vertetimin per likuidimin e taksave per tatimpaguesit

Moduli "Transferimi njoftimeve tek portali e-Albania" për lidhje me portalin e-albania ka si qëllim qasjen e plotë e në kohë reale të subjektit/qytetarit me të dhënat e tij të drejtorise se taksave dhe tarifave vendore duke përdorur si medium shërbimet digjitale të portalit e-Albania.

Per ndërtimin e modulit të lidhjes me portalin e-albania kërkohet:

- Të krijohen ndërfaqet e komunikimit me portalin e-albania (permes “web-service” apo librave perkatëse).
- Të integrohen shërbimet tek moduli e-shërbime në portalin e-albania permes ndërfaqeve të thjeshta dhe të sigurta në përdorim.
- Të krijohen ndërfaqe dinamike për shërbimet kryesore të sistemit të taksave (gjenerimi i njoftim detyrimeve subjektit/qytetarit, informimi mbi të dhënat që lidhen me taksat e tarifave vendore të subjektit/qytetarit etj.).
- Të realizohet sinkronizimi i të dhënave që do të transferohen nga sistemi i taksave dhe tarifave vendore te portali e-albania.
- Të gjenerohen raporte te fluksit të kërkesave mbi shërbimet që ofrohen për portalin e-Albania.

2. Kryerjen e pagesave on line.Sistemi duhet funksionojë nepermjet:

- EASY PAY
- AK-INVEST
- UNIONI FINANCIAR
- Posta Shqiptare
- Etj.

Për të qenë sa më afër subjekteve dhe lehtësuar atyre mënyrat dhe format e pagesave Bashkia kërkon që të zhvillojë Web Service për pranimin e pagesave kanalet e pagesave nepermjet Western Union, EasyPay, Postes Shqiptare etj. Kjo do të konsistoje ne:

- Ndërtimi i modulit (web service) për pranimin e pagesave online;
- Integrimi i modulit të pagesave online me sistemin aktual të taksave.

Për ndërtimin e modulit të pagesave online kërkohet sa vijon:

- Të realizohet lidhja me sistemet "backend" të sistemeve te pagesave
- Përvec publikimit të "web services" të sigurohet edhe funksionalitete te rëndësishme sic janë: Dekriptimi, Enkriptimi i elementeve Body, Kontrolli i sigurisë, Transformimi i te dhënave dhe Auditimi i Mesazheve.
- Të instalohen aplikacione shtesë për lidhjen me sistemet e sistemeve te pagesave, nëse është e nevojshme.
- Të administrohen lidhjet për importimin e të dhënave nga sistemi i pagesave online tek sistemi i taksave sipas filtrave kohore përkatës.

Për Integrimin e modulit "Web service për pagesat online" tek sistemi i taksave kërkohet sa vijon:

- Të realizohet përshtatja e infrastrukturës me sistemin aktual të taksave.
- Të konvertohen apo përshtaten atributet e të dhënave sipas referencave aktuale në sistemin e taksave.
- Të ndërtohen procedurat bazë për regjistrimin e pagesave dhe kalimin e tyre saktë sipas detyrimeve të subjektit.
- Të realizohen procedura të posaçme kontrolli për të siguruar integritetin e të dhënave.
- Të kalohen proceset në një fazë testimi, verifikimi dhe pranimi nga ana e sistemeve te pagesave (web service test)
- Të realizohen raporte të posaçme mbi ecurinë e pagesave sipas datave të ardhjes duke përdorur dhe filtrave të tjere të nevojshëm.
- Të realizohen raporte te detajuar mbi rakordimet apo mos rakordimet midis Bashkise dhe kanaleve të pagesave.
- Të krijohet një bazë të dhënash sekondare, për çdo informacion të marrë nga Kanalet e Pagesave për të reduktuar ngarkesën e web-service.

Të dhënat e pagesave përbëhen nga attribute të tilla si:

PAGESA

- ID
- NUIS (NIPT)
- ID njësia
- Emri i subjektit
- Referencë detyrimi
- Datë pagese
- Shuma e paguar
- Banka / Kanali i pagesës
- Referencë transaksioni
- Përdoruesi
- Datë sistemi

3. Moduli web per shfaqjen online i detyrimeve do t'i mundesoje cdo subjekti aksesin ne marrjen e informacionit mbi detyrimet e likujdura apo te palikujduara permes faqes web.

Komponentët bazë të modulit të gjenerimit online të njoftimit detyrimeve përmes faqes web duhet të jenë:

- Raportimi për taksat dhe tarifën papaguar\ të paguar.
- Printimin e njoftimit tatimor, apo shkarkimin si skedar.
- Modulin e ankesave
- Njoftimi online (me email)

Me ndryshimet në organizimin territorial dhe me zgjerimin e hartës së Bashkisë Kamez, rriti volumin e numrit të subjekteve dhe paralelisht u rrit edhe numri i kërkesave apo shërbimeve nga ana e tyre. Për të eliminuar një pjesë të ngarkesës që kanë sportelet nëpër njësitë administrative apo Bashkinë lindi nevoja për ndërtimin e një web-site për të informuar subjektet dhe qytetarët në lidhje me detyrimet, ndryshimet ligjore, vendimet e këshillit bashkiak etj. Përveç rolit informues, portali duhet të ofrojë dhe shërbime të ndryshme si:

Web-site

- Informimi në lidhje me afatet e detyrimeve (nëpërmjet postës elektronike).
- Informimi në lidhje me mënyrën e pagesës së detyrimeve.
- Informimi në lidhje me pikat dhe njësitë ku mund të kryhen pagesat.
- Raport mbi listën e detyrimeve aktuale dhe ato ndër vitesh.
- Raport mbi listën e detyrimeve të likuajuara.
- Raporti mbi të dhënat e subjektit.
- Printimi i Njoftimit Detyrimi.
- Printimi i Faturës së Arketimit.
- Depozitimin e ankesave të ndryshme.
- Dërgimin e kërkesave nëpërmjet postës elektronike.

Të gjitha këto shërbime kërkojnë patjetër qasje në web-site, kredencialet tërhiqen tek zyrat e njësisë administrative apo tek Bashkia Kamez duke u identifikuar si administratori i subjektit.

Web-admin

Përveç ndërfaqes web, moduli për "Njoftimi dhe Informimi online i qytetarëve" përmban edhe aplikacionin për menaxhimin e këtij portali. Aplikacioni duhet të kryejë shërbimet e mëposhtme:

- Gjenerimin e fjalëkalimeve për subjektet e reja
- Dërgimin e mesazheve elektronike për të gjitha subjektet në lidhje me afatet e detyrimeve të caktuara.
- Kthimin e përgjigjeve në lidhje me ankesat e subjekteve.
- Hedhjen në sistem të afateve të detyrimeve.
- Ngarkimi i njoftimeve të ndryshme në Web-site.

3.8 Te tjera

Ofertuesi krahas zhvillimit të software (instalimit dhe konfigurimit të sistemit/backup automatik të tij) kërkon ofrimin e shërbimeve që do të konsistojnë në trajnimin mirëmbajtjen, asistencën teknike të sistemit menaxhimin që do të instalohet për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore si më poshtë:

Instalime dhe Konfigurime

- ✓ Te realizohen instalimet dhe konfigurimet për venien në punë të plotë të sistemit.

Backup automatik

- ✓ Te realizohet një modul për backup automatik ditor (në fund të ditës së punës) të sistemit.

Trajnimi

- ✓ Trajnimi i përdoruesve për çdo ndërfaqe të përdorimit sipas rolit dhe të drejtave në sistemin e përmirësuar .
- ✓ Trajnimi mbi task-et e administrimit të sistemit

Mirëmbajtja

- ✓ Suport në rast ndërprerje të procesit të punës për shkak të mos funksionimit të programit
- ✓ Suport në rast problemi gjatë instalimit të programit tek klientet e tjerë ose tek server-i
- ✓ Suport në rast problemi me databazën, shkëputja e lidhjes, ndalesat e shërbimeve të server-it.
- ✓ Suport në rastet e restore-ve të databazës e backup-ve manuale.
- ✓ Suport në rikonfigurimin e sistemit, në rast ndryshimi të teknologjisë
- ✓ Azhurnimi i programit me ndryshimet dhe përmirësimet e reja (Versionet e reja të programit) që mund të realizohen nga vetë kontraktuesi, pa kërkesën e Përdoruesit.
- ✓ Përshtatja e referencave të programit, për shkak të ndryshimeve të akteve ligjore ose ndryshimeve në paketat fiskale të taksave.

Asistencë teknike për zgjidhjen e problemeve të krijuara nga përdoruesit gjatë shfrytëzimit të programit

- ✓ Asistencë on line në rast të regjistrimit të gabuar të referencave.
 - ✓ Asistencë on line për rregullimin e problemeve në databazë në rast gabimesh që kanë lindur si pasojë e veprimeve jo të sakta nga ana e përdoruesit.
 - ✓ Asistencë për përpunime të ndryshme të informacionit në bazën e të dhënave sipas kërkesave specifike të përdoruesve
 - ✓ Punime për rritjen e sigurisë së të dhënave dhe vetë programit
 - ✓ Punime për përmirësimin e eficiencës së programit
 - ✓ Punime për modifikimet e raporteve sipas kërkesave
-
- Azhurnimi i programit me ndryshimet dhe përmirësimet e reja (Versionet e reja të programit) që mund të realizohen nga ve të Sipërmarrësi, pa kërkesën e Përdoruesit.
 - Përshtatja e referencave të programit, për shkak të ndryshimeve të akteve ligjore ose ndryshimeve në paketat fiskale të taksave.

Shënim: Nëse Operatori Ekonomik fitues pasi të njihet me sistemin ekzistues vlerëson se implementimi i një sistemi të ri për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore është zgjidhje me e mirë se upgrade dhe zhvillimi i sistemit ekzistues për realizimin e detyrave të mesipërme të percaktuara në keto Terma Reference, duhet që kete propozim t'ja drejtoje Autoritetit Kontraktor i cili duhet të japë një miratim me shkrim për kete propozim. Në cdo rast sistemi i ri duhet:

- ✓ Te plotesoje të gjitha kërkesat në Termat e References

-
- ✓ Çmimi i ofruar nga Operatori Ekonomik ne oferten e tij fituese nuk do te ndryshoje.
 - ✓ Afatet e realizimit e implementimin nuk do te ndryshojne.
 - ✓ Pervec sherbimeve te mesiperme Operatori ekonomik duhet te kryeje migrimin e te dhenave nga baza e te dhenave te sistemit ekzistues ne ate te sistemit te ri
 - ✓ Sistemi i ri duhet te jete ne shfrytezim ne te pakten 3 Bashki

3. Afati i realizimit

Implementimi i upgrade e realizimi i web serviseve ne sistemin e menaxhmit te taksave do te kryhet brenda nje periudhe 2 mujore pas lidhjes se kontrates kurse mirembajtje do te realizohet per nje periudhe 12 mujore pas implementimit.

4. Shperndarja

Sistemi eshte instaluar ne Bashkine Kamez

5. Vendi dhe dorezimi i sherbimeve

Sherbimet do te dorezohen ne Bashkine Kamez

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, nga data e publikimit të Njoftimit të Kontratës në vlerën prej jo më pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Kopje te vërtetuara te bilanceve te vitit, 2019, 2020, 2021 te konfirmuara nga Organi Tatimor.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2022, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar, shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi te pakten në vlerën totale 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik, ne rastin e kontratave të realizuara me një ent publik, duhet të paraqesë kopje të kontratave të ngjashme si dhe vërtetimet e realizimit të shërbimit të leshuara nga enti publik ose/dhe faturat tatimore perkatëse të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik, ne rastin e kontratave të realizuara me sektorin privat, duhet të paraqesë kopje të kontratave të ngjashme si dhe faturave tatimore perkatëse të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë te pakten 7 vjet përvojë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të ketë në objektin e tij të aktivitetit zhvillimin e mirëmbajtjes së sistemeve software. Kjo duhet të vërtetohet me:

- Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar të Operatorit Ekonomik leshuar nga QKR
- Profili (CV) i Operatorit Ekonomik

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 15 të punësuar në një periudhë jo më pak se 3 muaj para datës së shpalljes së kësaj procedure prokurimi.

